



STATUTI I URDHRIT TË PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Krijimi i Urdhrit të Psikologut

1. Urdhri i Psikologut është krijuar në bazë të Ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Statusi i Urdhrit të Psikologut

1. Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, në vijim Urdhri i Psikologut, është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbrohet interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtaritë e marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.
2. Urdhri organizohet sipas Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, sipas të cilit me Ent Publik kuptohet çdo subjekt i së drejtës publike, joshetëror, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik.
3. Urdhri i Psikologut është person juridik i pavarur, profesional, i depolitizuar, i hapur për të gjithë anëtarët, pavarësisht nga përkatësitë e tyre racore, etnike, fetare, gjinore apo politike.

Neni 3

Parimet themeluese

1. Parimet themeluese të strukturës dhe funksionimit të Urdhrit janë barazia e anëtarëve të tij përpara ligjit dhe normave të urdhrit, e drejta e anëtarëve të tij për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në të gjitha detyrat dhe funksionet e urdhrit, marrja e vendimeve me shumicë të thjeshtë dhe aktiviteti i lirë në respektim të ligjit.
2. Urdhri ka shtrirje në të gjithë territorin kombëtar.

Neni 4

Misioni i Urdhrit të Psikologut

1. Misioni i Urdhrit të Psikologut është nxitja dhe ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e psikologjisë, si dhe mbrojtja e përfituesve të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit të psikologut.

2. Për realizimin e qëllimit të tij, Urdhri i Psikologut ushtron këto kompetenca:

- a) jep dhe heq të drejtën për ushtrimin e profesionit të psikologut;
- b) mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit të Psikologut dhe menaxhon sistemin e administrimit e të përditësimit të tij;
- c) nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional e etik të anëtarëve të Urdhrit;
- ç) vendos standarde etike e deontologjike, të detyrueshme për çdo psikolog dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;
- d) mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre e të profesionit të psikologut;
- dh) nxit dhe ndihmon marrjen e masave, me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar nga ushtruesit e profesionit dhe mbrojtjen e përfituesit të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit;
- e) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, institucionet e tjera, shkencore dhe arsimore, për të siguruar standarde në edukimin e vazhdueshëm, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të Urdhrit;
- ë) informon publikun, nëpërmjet faqes zyrtare të Urdhrit, për të gjitha aktet e miratuara nga organet e Urdhrit, të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 5

Funksionet e Urdhrit

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 27.07.2018 të Asamblesë II Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

- 1. Për përmbushjen e qëllimeve të tij, Urdhri do të ushtrojë funksionet e mëposhtme:
 - a) T'u lehtësojë anëtarëve të tij ushtrimin e profesionit, duke synuar rritjen e nivelit profesional në bashkëpunim me administratën publike dhe iniciativën private, kur është e nevojshme.
 - b) Të veprojë sipas ligjit për përfaqësimin dhe mbrojtjen e profesionit përpara çdo organi të administratës shtetërore, institucioneve publike dhe private, gjykatave, enteve dhe individëve, duke mbajtur qëndrim në çdo çështje që prek interesat profesionale dhe duke mundësuar të drejtën për ankim në përputhje me ligjin.
 - c) Të propozojë reforma legjislative, që i gjykon të drejta për mbrojtjen e profesionit.
 - d) Të vendosë, brenda kompetencave të tij ligjore, për kriteret dhe mënyrën e ushtrimit të profesionit, duke u kujdesur që profesioni i psikologut të ushtrohet në përputhje me kriteret dhe standardet etike dhe deontologjike dhe në respekt të të drejtave të individëve, duke ushtruar për këtë qëllim autoritetin disiplinor në aspektin profesional.
 - e) Të garantojë një organizim efikas të Urdhrit, duke promovuar shtrirjen në të gjithë territorin, duke nxitur veprimtari dhe shërbime në interes të Urdhrit, në aspektin formues, kulturor, të asistencës dhe të formimit profesional.
 - f) Të mbrojë anëtarët e Urdhrit në ushtrimin e të drejtave që u takojnë për ushtrimin e funksioneve të tyre profesionale.

- g) Të sigurojë harmoninë dhe bashkëpunimin midis anëtarëve të Urdhrit, duke ndaluar konkurrencën e pandershme midis tyre, duke ndërhyrë edhe me rrugën e pajtimit ose arbitrazhit për çështjet që, për arsye profesionale, hapen midis tyre, si edhe, sipas rastit, të zgjidhë me vendim, me kërkesë të të interesuarve, mosmarrëveshjet e lindura në përmbushjen e detyrimeve, që burojnë nga ushtrimi i profesionit.
- h) Të marrë masa që çojnë në shmangien e ndërhyrjes në profesion nga çdo organ administrativ apo shtetëror, duke denoncuar, paditur apo kundërshtuar përpara çdo organi të administratës dhe përpara gjykatave të të gjitha niveleve çdo çështje, që është konstatuar si e tillë nga mbledhja e Këshillit Kombëtar.
- i) Të liçencojë punën profesionale të psikologëve, sipas kualifikimit të përfutur, pa ndikuar në honoraret profesionale dhe as në kushtet e tjera kontraktuale, përcaktimi i të cilave lihet në vendimin e lirë të palëve.
- j) Të administrojë ekonominë e Urdhrit, duke mbajtur në konsideratë parimin e ruajtjes së balancës midis nevojave, interesit publik dhe barrës financiare për caktimin e kuotave, tarifave dhe kontributeve, dhe të ushtrojë autoritetin e nevojshëm për mbledhjen dhe menaxhimin e tyre.
- k) Të marrë pjesë, sipas ligjit, në çdo organizim të çdo organi të administratës publike, që ka të bëjë me çështje të kompetencës profesionale, përfshirë edhe hartimin e programeve të studimit, si dhe të informojë anëtarët, kur është e nevojshme, mbi kushtet dhe kriteret e organizimit të qendrave të mësimdhënies, ku duhet të ndiqen kurse studimi, që do të lejojnë marrjen e kualifikimeve, që lejojnë ushtrimin e profesionit.
- l) Të përgatisë informacionin e nevojshëm për të lehtësuar aksesin në jetën profesionale të psikologëve të rinj.
- m) Të bashkëpunojë me çdo organ ligjzbatues për krijimin e bazës së të dhënave profesionale të anëtarëve të Urdhrit, që kanë kualifikimin e duhur të ushtrojnë profesionin si ekspertë psikologë. T'u mundësojë çdo organi ligjzbatues akses në të dhënat e anëtarëve të Urdhrit, të cilët mund të kërkojnë si ekspertë në çështjet gjyqësore.
- n) Të marrë përsipër përfaqësimin e profesionit në kuadrin ndërkombëtar.
- o) Të zbatojë dhe të ushtrojë autoritetin tek anëtarët, që të zbatojnë ligjet e përgjithshme dhe të veçanta, statutet profesionale dhe rregulloret e organizimit të brendshëm, si edhe normat dhe vendimet e marra nga organet kolegjiale brenda kompetencës së tyre.
- p) Të kujdeset për shpërndarjen e drejtë të informacionit profesional dhe përdorimin pa kufizim të materialeve profesionale për të gjithë anëtarët.
- q) Të ushtrojë të gjitha funksionet e tjera, që i atribuohen nga dispozitat ligjore ose që janë në të mirë të interesave profesionale të anëtarëve të urdhrit ose të vetë profesionit.

Neni 6

Bashkëpunimi

1. Urdhri i Psikologut, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministritë përgjegjëse për çështjet sociale, arsimin, shëndetësinë, drejtësinë, punët e brendshme, mbrojtjen dhe institucionet e tyre vartëse, institucionet e pavarura dhe organizma të tjera, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi, publike ose private.
2. Urdhri i Psikologut informon çdo 6 muaj ministritë e përmendura në pikën 1, të këtij neni, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, lidhur me anëtarësimet e psikologëve, gjykimet disiplinore dhe ecurinë e tyre në të gjitha shkallët e gjyimit profesional.
3. Inspektoratet në fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive të përmendura në pikën 1, të këtij neni, bashkëpunojnë me Urdhrin e Psikologut gjatë ushtrimit të funksionit të tij.
4. Ministritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni bashkëpunojnë me Urdhrin për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumenteve të rëndësishme në fushën e shërbimeve psiko-sociale.
5. Urdhri i Psikologut bashkëpunon me të gjitha entet kombëtare apo ndërkombëtare që operojnë në fushën e psikologjisë.
6. Urdhri i Psikologut synon të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi reciprok me organizmat analoge në vendet e tjera dhe të anëtarësohet me të drejta të plota në organizmat ndërkombëtare që ndihmojnë për të përmbushur misionin e tij.
7. Urdhri i Psikologut bashkëpunon me të gjithë institucionet e arsimit të lartë, publike dhe jopublike.

Neni 7

Statuti

1. Statuti i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, më tej Statuti, ka për qëllim rregullimin normativ të veprimtarisë të Urdhrit të Psikologut dhe organeve të tij.
2. Statuti miratohet nga Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Psikologut.

KREU II

ANËTARËSIMI NË URDHRIN E PSIKOLOGUT

Neni 8

Kriteret e anëtarësimit

1. Anëtarët e Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë diplomën e studimeve të larta “Bachelor” dhe “Master shkencor” ose “Master profesional” në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;

ç) të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

2. Anëtarë të Urdhrit të Psikologut bëhen edhe psikologët, shtetas shqiptarë dhe të huaj, të diplomuar jashtë vendit, pas njohjes së diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

3. Shtetasi i huaj, për ushtrimin e profesionit të psikologut në Republikën e Shqipërisë, duhet të anëtarësohet paraprakisht në Urdhrin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë. Çdo psikolog, shtetas i huaj, rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht, për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatën e mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga urdhri/dhoma apo shoqata e psikologëve të vendit të vet, të njohur nga vendi ynë, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;

c) njohjen e diplomës e të certifikatave të specializimeve nga organi kompetent, të kryera prej tij/saj;

ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Psikologut;

d) dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, të vërtetuar nga një autoritet i licencuar nga shteti.

dh) për psikologun e huaj, i cili nuk njeh gjuhën shqipe, detyrimisht është kusht të punojë me përkthyes.

4. Shtetasit shqiptarë dhe të huaj bëhen menjëherë anëtarë të Urdhrit të Psikologut, me depozitimin e dosjes, pranimin e saj, pagimin e kuotizacionit dhe regjistrimin pranë tij.

5. Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim dhe procedura e regjistrimit rregullohen me Rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

6. Anëtarësimi në Urdhër mund të bëhet si anëtar ushtrues dhe si anëtar jo ushtrues i profesionit.

Neni 9

Detyrimi për anëtarësi

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e psikologut në sistemin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut dhe pa qenë i pajisur me liçencën për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga ky organizëm.
2. Punëdhënësit e institucioneve publike dhe private ndalohen t'i punësojnë psikologët në kundërshtim me këtë dispozitë.

Neni 10

Pagesa për anëtarësim

1. Kërkuesi paguan tarifën, e cila përcaktohet çdo vit me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut për veprimet e kryera për anëtarësim, regjistrim dhe licensim.
2. Për subjektet e huaja, Këshilli Kombëtar mund të vendosë tarifa të veçanta.

Neni 11

Arsyet e refuzimit të anëtarësimit në Urdhër

1. Anëtarësimi në urdhër mund t'i refuzohet të interesuarit vetëm në rastet e mëposhtme:
 - a) Kur nuk plotëson kriteret e kërkuara nga ligji.
 - b) Kur nuk paguhen kuotat përkatëse të Urdhrit.
 - c) Kur është marrë vendim i formës së prerë kundër të interesuarit, që e dënon me ndalim të ushtrimit të profesionit.
2. Vendimi i refuzimit të anëtarësimit në Urdhër i duhet komunikuar kërkuesit i arsyetuar dhe nuk përjashton rrugën administrative të ankimit.
3. Procedura e anëtarësimit dhe ndërprerjes së anëtarësisë përcaktohet në Rregulloren e regjistrimit, anëtarësimit dhe liçencimit të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

Neni 12

Humbja e statusit si anëtar i Urdhrit

(Ndryshuar me vendimin nr.3, datë 02.06.2023 të Asamblesë VII-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Statusi si anëtar i urdhrit humbet në rastet e mëposhtme:
 - a) Vdes.
 - b) Me kërkesë të vetë anëtarit, pa shmangur detyrimet që janë për t'u përmbushur ndaj Urdhrit.

c) Kur ka një dënim për ndalim të ushtrimit të profesionit të dhënë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

d) Për mospagesë të kuotës së urdhrit ose të kontributetve të tjera të parashikuara nga Urdhri pas përfundimit të vlefshmërisë së Kartës së Anëtarësimit, datë 31 Janar të çdo viti kalendarik.

e) Në rastin e kryerjes së një sanksioni disiplinor të dhënë, në përputhje me parashikimet në Statut.

2. Këshilli Kombëtar mund të vendosë për pezullimin e përkohshëm të anëtarësimit kur vihet në dijeni për hapjen e një çështje gjyqësore ose procedim të një anëtari për një vepër penale, masa e dënimit të së cilës mund të parashikojë edhe ndalimin e ushtrimit të profesionit. Ky vendim i marrë duhet të jetë i motivuar, duke dëgjuar paraprakisht të interesuarin dhe i bazuar në rrethanat përkatëse.

Neni 13

Ankimi për refuzimin e anëtarësimit dhe humbjes së statusit të anëtarit

1. Ndaj vendimit që refuzon kërkesën për anëtarësim e regjistrim ose që vendos humbjen e statusit të anëtarit, kërkuuesi ka të drejtë të ankohej pranë Këshillit Kombëtar, jo më vonë se 30 ditë nga dita e marrjes së njoftimit për vendimin.

2. Këshilli Kombëtar e shqyrton atë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e ankesës dhe merr vendim, i cili është i formës së prerë.

3. Kërkuuesi ka të drejtë t'i drejtohet Urdhrit përsëri me kërkesë për anëtarësim vetëm 12 muaj pas përgjigjes negative nga Këshilli Kombëtar dhe vetëm nëse janë plotësuar kushtet për pranim.

Neni 14

Anëtarët e Nderit

1. Këshilli Kombëtar mund t'u japë titullin “Anëtar Nderi i Urdhrit” atyre personave që, për shkak të meritave të tyre shkencore, teknike ose profesionale, pavarësisht nga diploma e tyre, kanë kontribuar në zhvillimin e psikologjisë ose të profesionit të psikologut.

Neni 15

Të drejtat e anëtarit ushtrues

Anëtari ushtrues i Urdhrit të Psikologut ka të drejtë:

a) të ushtrojë profesionin sipas titullit të përcaktuar në diplomën e “Masterit shkencor” dhe/ose “Masterit profesional”;

b) të kërkojë krijimin e kushteve të favorshme për ushtrimin normal të profesionit, për edukimin e vazhdueshëm dhe për përparimin e karrierës;

- c) të kërkojë mbrojtje të veçantë, në rast rreziku gjatë ushtrimit të profesionit apo për rastet e rrezikut për jetën ndaj palëve të treta.
- ç) të ushtrojë profesionin në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me normat e Kodit Etiko-Deontologjik;
- d) të kërkojë mbrojtje nga Urdhri i Psikologut për shkeljen e të drejtave të tij profesionale dhe të Etikës e të Kodit nga cilido qoftë;
- dh) të ankohet në organet e Urdhrit ndaj çdo subjekti që i shkel të drejtën dhe mundësinë për të ushtruar profesionin në mënyrë të lirë dhe të pavarur;
- e) të zgjedhë e të zgjidhet në organet e Urdhrit të Psikologut;
- f) të marrë pjesë në shqyrtimin nga organet e Urdhrit të problemeve që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit prej tij;
- g) të apelojë vendime të Urdhrit të Psikologut kur i gjykon të padrejta.

Neni 16

Detyrat e anëtarit ushtrues

Anëtari ushtrues i Urdhrit të Psikologut ka këto detyra:

- a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale, në përshtatje me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;
- b) të punojë për rritjen e standardeve profesionale e të cilësisë së shërbimit në fushën e psikologjisë në institucionin ku punon dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit të vazhdueshëm;
- c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, tarifën e dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbimeve të tjera administrative, të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut;
- d) të paraqesë në Urdhër aktet profesionale, kontratat dhe dokumente të tjera, që mund t'i kërkojnë, në përputhje me dispozitat statutores ose ato të rregulloreve;
- dh) të njoftojë Urdhrin, në afatin kohor të 30 ditëve, për ndryshimet e të dhënave të nevojshme për regjistrim;
- e) të marrë pjesë aktive në jetën e Urdhrit, duke asistuar në Asamblëtë e Përgjithshme dhe në komisionet ose seksionet, në të cilat mund të thirret për shkak të profesionit;
- f) të ushtrojë me kujdes funksionet në të cilat është zgjedhur dhe të përmbushë ato detyra që organet e Urdhrit mund t'i caktojnë;
- g) të respektojë të drejtat profesionale ose ato që u njihen në Urdhër anëtarëve të tjerë;
- gj) të bashkëpunojë me Këshillin Kombëtar dhe, në veçanti, të japë deklaratë ose të lehtësojë dhënien e informacionit për çështjet në interes të Urdhrit, pa cënuar sekretin profesional.

Neni 17

Të drejtat e anëtarit joushtrues

Anëtari joushtrues i Urdhrit të Psikologut ka të drejtë:

- a) të përdorë shërbimet dhe mjetet profesionale të Urdhrit, sipas kushteve të përcaktuara nga rregulloret;
- a) të marrë pjesë si zgjedhës në të gjitha zgjedhjet, që do të thirren në kuadrin e Urdhrit dhe të marrë pjesë aktive në jetën e Urdhrit;
- b) të bëjë pjesë në Komisionet ose Seksionet, që mund të ngrihen, me përjashtim të Komisionit të Etikës dhe Gjyimit Disiplinor;
- c) të paraqesë pranë Këshillit Kombëtar shkresa me sugjerime, kërkesa dhe ankesa;
- d) të marrë informacion të rregullt mbi aktivitetet e Urdhrit me interes profesional, nëpërmjet buletineve, botimeve dhe udhëzimeve, si edhe me të gjitha mjetet, që gjykohen të përshtatshme.

Neni 18

Detyrat e anëtarit joushtrues

Anëtari joushtrues i Urdhrit të Psikologut ka këto detyra:

- a) të përmbushë normat e Urdhrit, si edhe vendimet e marra nga organet drejtuese të Urdhrit;
- b) të njoftojë Urdhrin, në afatin kohor të 30 ditëve, për ndryshimet e të dhënave të regjistrimit;
- c) të paguajë në kohë kuotat dhe tarifat e vendosura;
- d) të marrë pjesë aktive në jetën e Urdhrit, duke asistuar në Asamblëtë e Përgjithshme dhe në komisionet ose seksionet, në të cilat mund të thirret për shkak të profesionit;
- e) të përmbushë detyrat që organet drejtuese të Urdhrit mund t'i caktojnë;
- f) të respektojë të drejtat profesionale ose ato që u njihen në Urdhër anëtarëve të tjerë;
- g) të bashkëpunojë me Këshillin Kombëtar dhe në veçanti, të japë deklaratë ose të lehtësojë dhënien e informacionit për çështje në interes të Urdhrit, pa cënuar sekretin profesional;
- h) psikologët që, për arsye të ndryshme, nuk e kanë ushtruar profesionin e tyre për një periudhë mbi 7 vjet, mund t'i nënshtrohen një rikualifikimi dhe testimi që të regjistrohen/riregjistrohen për ushtrimin e profesionit. Programi dhe mënyrat e rikualifikimit dhe/ose testimit përcaktohen nga Këshilli Kombëtar.

KREU III
MBI PARIMET BAZË RREGULLUESE TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT

Neni 19
Ushtrimi i profesionit

1. Në çdo rast ushtrimi i profesionit duhet të jetë në përputhje me normat dhe standardet etike dhe deontologjike të përfshira në Kodin Etik dhe Deontologjik të Psikologut, të miratuar nga Urdhri.

Neni 20
Bazat e ushtrimit të profesionit

1. Ushtrimi i profesionit bazohet në parimin e autonomisë profesionale, kujdesin e duhur ndaj klientit dhe shërbimin për komunitetin.
2. Psikologu ka të drejtë dhe detyrë të ruajë sekretin profesional.
3. Psikologu ka detyrë të respektojë normat dhe standardet etike dhe deontologjike të vendosura në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë.

Neni 21
Edukimi i vazhdueshëm

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 27.07.2018 të Asamblesë II Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Psikologu duhet të përfshihet në edukimin e vazhdueshëm profesional, për të garantuar përditësimin e njohurive me të rejat në fushën e praktikës profesionale.
2. Organi përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe mbarëvajtjen e sistemit të edukimit në vazhdim është Komisioni i Edukimit në Vazhdim pranë Urdhrit të Psikologut, i cili ngrihet me vendim të Këshillit Kombëtar sipas dispozitave të këtij statuti.

Neni 22
Autonomia profesionale

1. Psikologu nuk duhet të pranojë asnjë punë që është kundër autonomisë së tij profesionale ose që mund të shkaktojë probleme, të cilat nuk mund të zgjidhen në stadin aktual të formimit të tij profesional.

Neni 23
Publiciteti dhe konkurrenca e pandershme

1. Psikologu duhet të ushtrojë profesionin e tij në kushtet e konkurrencës së lirë dhe, në lidhje me ofertën e shërbimeve dhe përcaktimin e pagesës së tij, duhet t'i nënshtrohet legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës, shmangies së konkurrencës së pandershme dhe shmangies së publicitetit të rremë.

2. Psikologu duhet të përpiqet, në përputhje me metodat shkencore, t'i ndajë njohuritë e tij me komunitetin profesional.

Neni 24
Të drejtat e klientit dhe/ose përfituesit të shërbimit

1. Klienti dhe, sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë, duhet të njohin objektivat dhe pasojat e mundshme të çdo procesi ose trajtimi që do të kryhet.

2. Në çdo rast, psikologu duhet të respektojë autonominë, lirinë vendimmarrëse dhe dinjitetin e klientit dhe/ose të përfituesit të shërbimit.

3. Kur gjendet përpara interesave personale ose institucionale të kundërta, psikologu duhet të përpiqet të kryejë aktivitetin e tij me paanshmëri maksimale.

Neni 25
Punët me shkrim

1. Të gjitha punimet profesionale, që duhen lëshuar në formë dokumenti, të tilla si: vlerësimet, raportet, analizat, diagnostikimet dhe punë të tjera analoge, firmosen nga profesionisti, duke shënuar numrin e tij të licencimit profesional dhe duke marrë përgjegjësinë për përmbajtjen dhe përshtatshmërinë e tyre me qëllimin për të cilin lëshohen.

2. Në punimet, raportet dhe vlerësimet e tij, psikologu duhet të bëjë të dallueshëm atë që paraqet në nivel hipoteze, nga përfundimet që ka arritur, bazuar në një arsyetim shkencor profesional.

KREU IV ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 26 Organet kryesore

1. Organet kryesore të Urdhrit janë:
 - a) Asambleja Kombëtare;
 - b) Këshilli Kombëtar;
 - c) Presidenti i Urdhrit;
 - ç) Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.
2. Me vendim të Këshillit Kombëtar, Urdhri i Psikologut mund të krijojë zyra rajonale në të gjithë vendin, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohet me Rregullore të veçantë.
3. Organet administrative të Urdhrit organizohen dhe funksionojnë sipas Rregullores Administrative të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

Neni 27 Asambleja Kombëtare

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues i Urdhrit dhe përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.
2. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga:
 - a) Presidenti i Urdhrit;
 - b) kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të Asamblesë.
3. Asambleja Kombëtare ka këto funksione:
 - a) zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;
 - b) miraton statutin e Urdhrit;
 - c) miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;
 - ç) miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;
 - d) miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe liçencimin;
 - dh) miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;
 - e) shqyrton dhe miraton projektbuxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;
 - ë) analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;
 - f) shqyrton raportin e auditit të jashtëm, në intervale trevjeçare.

Neni 28

Këshilli Kombëtar

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 27.07.2018 të Asamblesë II Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga:

- a) Presidenti i Urdhrit;
- b) nga një përfaqësues i ministrive përgjegjëse për arsimin, shëndetësinë, drejtësinë, mbrojtjen dhe çështjet sociale;
- c) tre pedagogë të psikologjisë, me gradë shkencore Profesor, Prof. i Asociuar dhe Doktor Shkencash, që punojnë në institucione të arsimit të lartë, nga universitetet publike dhe private;
- ç) shtatë psikologë që punojnë në shkolla, spitale, burgje, institucione komunitare, gjykatë, zyra apo agjenci private, institucione rezidenciale, si dhe institucione varësie;
- d) një anëtar nga Shoqatat e Psikologëve.

2. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

- a) miraton strukturën e vet organizative;
- b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
- c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;
- ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
- d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim, Asamblesë Kombëtare;
- dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;
- e) ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesionit të psikologut;
- ë) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe financiar;
- f) jep titullin “Anëtar Nderi i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë” për personalitete me kontribute të rëndësishme në fushën e psikologjisë.

3. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 4 vjet.

4. Anëtari i zgjedhur i Këshillit Kombëtar e përfundon mandatin e tij përpara kohe kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) dënohet me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- c) humbet zotësinë e plotë për të vepruar;
- ç) bëhet i paaftë, për arsye shëndetësore, për të kryer detyrat e tij, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;
- d) mungon pa arsye të justifikuar në gjashtë mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit Kombëtar.
- e) humbet statusin e anëtarit të Urdhrit të Psikologut

5. Konstatimi i ndërprerjes së mandatit të anëtarit të zgjedhur të Këshillit Kombëtar bëhet me shumicë të thjeshtë nga Këshilli Kombëtar. Zëvendësimi i anëtarit, të cilit i është ndërprerë mandati, bëhet nga Asambleja Kombëtare, brenda të njëjtës kategori të përcaktuar nga neni 28,

vetëm për periudhën e mbetur të mandatit, në mbledhjen e saj më të parë. Plotësimi i mandatit prej anëtarit zëvendësues nuk konsiderohet si mandat i plotë në kuptim të nenit 29.2 të këtij ligji.

Neni 29

Kriteret për anëtarësim në Këshillin Kombëtar

1. Anëtari i Këshillit Kombëtar duhet të plotësojë këto kriterë:
 - a) të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Shqipëri;
 - b) të jetë anëtar i Urdhrit të Psikologut;
 - c) të ketë përvojë jo më pak se 5 vjet në ushtrimin e profesionit të psikologut;
 - ç) të mos ketë marrë masë disiplinore në 5 vitet e fundit dhe të mos ketë asnjë precedent penal.
2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar kanë të drejtën e vetëm të një rizgjedhjeje.

Neni 30

Njoftimi për mbledhjet e Këshillit

1. Presidenti njofton për datën, kohën dhe rendin e ditës së çdo mbledhje. Mbledhja e Këshillit njoftohet me shkrim, si rregull, 7 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës.

Neni 31

Marrja e vendimeve

1. Këshilli Kombëtar merr vendim vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve janë dakord për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

Neni 32

Vlefshmëria e mbledhjes

1. Mbledhja e Këshillit Kombëtar është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 1/2 e anëtarëve.
2. Kur në hapjen e mbledhjes kjo shumicë nuk arrihet, atëherë, Presidenti apo zëvendësi, që drejton mbledhjen, vendos thirrjen e mbledhjes një ditë tjetër, duke përsëritur njoftimin me shkrim.

Neni 33

Procesverbali i mbledhjes

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 27.07.2018 të Asamblesë II Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal ku shkruhet data, vendi i mbledhjes, pjesëmarrësit, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe forma e rezultati i votimit. Presidenti cakton një person për mbajtjen e procesverbalit.
2. Në mbarim të mbledhjes, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi (sekretari) dhe Presidenti ose zëvendësi që ka drejtuar mbledhjen. Procesverbali i paraqitet në mbledhjen pasardhëse të gjithë anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje, me të drejtën për të nënshkruar me vërejtje për çdo kundërshtim që kanë në lidhje me përmbajtjen e procesverbalit. Të gjitha procesverbalet e mbledhjeve ruhen detyrimisht.

Neni 34

Forma e votimit

1. Vendimet merren me votime të hapura, përveç rasteve kur, për arsye e rrethana të veçanta, me propozim të Presidentit, vendoset ndryshe.
2. Vendimet, që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi, merren vetëm me votim të fshehtë.

Neni 35

Vlefshmëria e votës për të marrë vendime

1. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje, përveç rasteve kur kërkohet një shumicë e cilësuar. Kur kjo e fundit nuk arrihet, atëhere kryhet një votim i dytë. Nëse edhe në votimin e dytë situata përsëritet, atëhere vendimi shtyhet në një mbledhje tjetër, në të cilën është e mjaftueshme një shumicë e thjeshtë votash.
2. Në rastet kur votat barazohen dhe votimi është i hapur, vendos vota e Presidentit.

Neni 36

Presidenti i Urdhrit

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 27.07.2018 të Asamblesë II Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Presidenti i Urdhrit zgjidhet me votim të fshehtë nga Asambleja Kombëtare.
2. Mandati i presidentit është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
3. Kandidaturat për President të Urdhrit të Psikologut duhet të përmbushin këto kritere:
 - a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
 - b) të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë në profesion;
 - c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;
 - ç) të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore në 5 vitet e fundit;
 - d) të kenë prestigj dhe reputacion etiko-moral e profesional;
 - e) të kenë kryer botime shkencore;
 - ë) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
4. Funksioni i presidentit të Urdhrit të Psikologut është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.
5. Presidenti i Urdhrit e përfundon mandatin e tij përpara kohe kur:
 - a) merret vendim nga Asambleja Kombëtare, me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
 - ç) humbet zotësinë e plotë për të vepruar;
 - d) bëhet i paafte, për arsye shëndetësore, për të kryer detyrat e tyre, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor.
5. Në rastet kur Presidentit i përfundon mandati përpara kohe për ndonjë nga arsyet e parashikuara nga pika 5 e këtij neni, kompetencat e tij i ushtron anëtari më i vjetër i Këshillit Kombëtar, i cili brenda 10 ditëve thërret Këshillin Kombëtar për të konstatuar ndërprerjen e mandatit të Presidentit dhe thërret mbledhjen e Asamblesë Kombëtare për zgjedhjen e Presidentit të ri, e cila duhet të mbahet jo më vonë se 30 ditë nga konstatimi i ndërprerjes së mandatit të Presidentit.
6. Presidenti ka këto kompetenca dhe detyra:
 - a) Të përfaqësojë institucionin në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe administrative dhe të nënshkruajë, kur është rasti, në emër të tij;
 - b) Të delegojë kompetencat e tij nëpërmjet urdhërave të brendshëm, referuar legjisllacionit, statutit dhe akteve të tjera normative në fuqi, në rast mungese ose me porosi;
 - c) Të drejtojë mbledhjet e Këshillit Kombëtar;
 - d) Të organizojë dhe drejtojë veprimtarinë e të gjithë institucionit për të siguruar funksionimin sa më të mirë të punës;
 - e) Të ndjekë bashkëpunimin me institucionet e tjera;

- f) Të lidhë kontratat individuale me çdo punonjës të institucionit dhe t'i zgjidhë ato sipas legjislacionit të punës në fuqi;
 - g) Të drejtojë përpilimin e buxhetit dhe caktimin e prioriteteve për përdorimin e tij në mënyrë sa më të frytshme;
 - h) Të garantojë disiplinimin e administrimit të dokumentacionit në institucion në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;
 - i) Të sigurojë etikën profesionale brenda institucionit së bashku me stafin;
 - j) Të përfaqësojë institucionin në marrëdhëniet me publikun, duke mbajtur qëndrim zyrtar në emër të tij.
7. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e Presidentit të Urdhrit të Psikologut përcaktohen në Rregulloren e Zgjedhjeve dhe Rregulloren Administrative të Urdhrit.

Neni 36/1

Sekretari i Përgjithshëm

(Shtuar me Vendimin Nr.4 datë 13.05.2022 të Asamblesë së VI-të Kombëtare)

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjësi kryesor për problemet tekniko-organizative të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut si dhe të komisioneve që funksionojnë pranë Urdhrit të Psikologut.
2. Sekretari Përgjithshëm nëpërmjet ushtrimit të funksioneve dhe të bashkërendimit të punës së strukturave të institucionit, kujdeset dhe siguron qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e veprimtarive përkatëse të Urdhrit të Psikologut me institucionet e tjera.
3. Në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe urdhrat ose detyrat e marra nga Presidenti i Urdhrit të Psikologut, Sekretari i Përgjithshëm merr masa për shfrytëzimin e frytshëm të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare e burimeve materiale të urdhrit.
4. Paga e Sekretarit të Përgjithshëm është në masën 80% të pagës së Presidentit të Urdhrit.

Neni 36/2

Menyra e zgjedhjes

1. Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Neni 36/3
Kriteret e perzgjedhjes

1.Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit të Psikologut duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
- c) të ketë përfunduar studimet e larta e të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë sipas legjislacionit në fuqi;
- d) të ketë aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;
- e) të ketë integritet dhe reputacion etiko-moral;

Neni 36/4

Lirimi i parakohshëm nga detyra

1.Lirimi i parakohshëm nga detyra e Sekretarit të Përgjithshëm bëhet kur:

- a) paraqet kërkesë me shkrim për dorëheqje;
- b) dënohet me vendim të formës së prerë në lidhje me detyrat që ushtron
- c) bëhet i paaftë për arsye shëndetësore;
- d) nëpërmjet veprimeve dhe/ose mosveprimeve bëhet pengesë për mbarëvajtjen e punës së insitucionit;
- e) në çdo rast kur sjellja apo qëndrimet e tij çenojnë imazhin e institucionit;

2.Vendimi për lirimin e parakohshëm nga detyra e Sekretarit të Përgjithshëm merret nga jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Neni 36/5

Detyrat dhe funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm

1.Sekretari i Përgjithshëm kryen këto detyra:

- a) kontrollon mbarëvajtjen e punës së Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut

- b) koordinon punën dhe veprimtarinë e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.
- c) kujdeset për krijimin dhe organizimin e komisioneve dhe grupeve të punës që ngrihen pranë Këshillit Kombëtar.
- d) organizon dhe drejton punën për hartimin e zbatimin e Kodit Etik e Deontologjik si dhe rregulloreve të miratuara të Urdhrit të Psikologut.
- e) organizon marrëdhëniet publike dhe kontaktet me insitucionet e tjera publike e jo publike në vend, si dhe me organizata e forume ndërkombëtare.
- f) raporton dhe informon sistematikisht Presidentin lidhur me mbarëvajtjen e punës dhe detyrat specifike të tij.
- g) organizon dhe drejton punën në lidhje me publikimin e Raporteve Vjetore të punës së insitucionit të Urdhrit të Psikologut apo të publikime të tjera.

Neni 37

Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionon Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional, si organizëm i gjykimit profesional. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, jo nga anëtarët e vet.
2. Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë.
3. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit Etik të Gjykimit Disiplinor Profesional përcaktohet në Rregulloren e Gjykimit Profesional të Urdhrit.

Neni 38

Masat disiplinore

1. Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional heton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara dhe seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:
 - a) vërejtje me shkrim;
 - b) vërejtje me paralajmërim;
 - c) gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë;
 - ç) propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione publike dhe private;
 - d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut deri në 3 vjet;

- e) përjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë deri në 3 vjet.
2. Masat disiplinore, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të shlyhen në qoftë se ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore:
- a) brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni;
- b) brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “d” e “dh”, të pikës 1, të këtij neni.
3. Të ardhurat nga gjobat e mbledhura, në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

Neni 39

Ankimi

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i paraqiten Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.
2. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës, e merr në shqyrtim ose ngre një komision *ad hoc* dhe jep vendimin për ankesën e paraqitur.
3. Vendimi i Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 40

Komisione të tjera

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 27.07.2018 të Asamblesë II Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

- 1.Me vendim të Këshillit Kombëtar, në varësi të detyrave dhe problemeve, sipas rastit, krijohen komisione të përhershme ose të përkohëshme për:
- Liçencimin dhe riliçencimin;
 - Praktikat profesionale;
 - Standardet, arsimimin dhe kualifikimin;
 - Marrëdhëniet publike dhe me jashtë;
 - Planifikimin dhe kontrollin ekonomiko-financiar;
 - Nxjerrjen e një organi periodik dhe botime të tjera.
- 2.Veprimtaria e këtyre komisioneve bazohet në rregulloret përkatëse, të cilat miratohen nga Këshilli Kombëtar.

Neni 40.1

Komisioni i Edukimit në Vazhdim i Urdhrit të Psikologut

1. Komisioni i Edukimit në Vazhdim i Urdhrit të Psikologut është organ kolegjal, që ushtron veprimtarinë e tij bazuar në ligjin 40/2016 « Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë» dhe legjislacionin tjetër të posaçëm në fuqi, në dispozitat e këtij statuti, si dhe në aktet e tjera të miratuara nga organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut për këtë qëllim.
2. Komisioni i Edukimit në Vazhdim gëzon autonomi në vendimmarrjen në lidhje me funksionimin dhe mbarëvajtjen e sistemit të edukimit në vazhdim në psikologji, në përputhje me dispozitat që parashikon ky statut.

Neni 40.2

Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë të Komisionit të Edukimit në Vazhdim

1. Komisioni i Edukimit në Vazhdim ka qëllim të garantojë ruajtjen e standardeve në lidhje me trajnimet profesionale të psikologëve, nëpërmjet miratimit, akreditimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të programeve të trajnimit profesional në psikologji, në kuadër të procesit të edukimit në vazhdim, për psikologët që ushtrojnë profesionin.
2. Urdhri i Psikologut, nëpërmjet Komisionit të Edukimit në Vazhdim, bazuar në marrëveshje reciproke dhe në varësi të kapaciteteve, mund të miratojë, çertifikojë dhe mbikëqyrë veprimtari të formimit profesional edhe për profesione të tjera, për të cilat kërkohet formim i posaçëm psikologjik në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Objekti i veprimtarisë së Komisionit të Edukimit në Vazhdim është miratimi, akreditimi, mbikëqyrja dhe promovimi i programeve trajnuese dhe kërkimeve në fushën e trajnimit dhe të zhvillimit profesional të psikologeve; bashkërendimi dhe mbikëqyrja e trajnimeve, kërkimit shkencor dhe zhvillimit institucional në fushën e psikologjisë.

Neni 40.3

Statusi dhe përbërja e Komisionit të Edukimit në Vazhdim

1. Komisioni i Edukimit në Vazhdim është organi më i lartë vendimmarrës i Urdhrit të Psikologut në lidhje me miratimin, akreditimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programeve të trajnimit profesional në psikologji. Ai përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët Presidenti i Urdhrit të Psikologut është anëtar për shkak të detyrës dhe njëkohësisht kryetar i këtij Komisioni, për shkak të detyrës, ndërsa 4 anëtarët e tjerë përzgjidhen nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, me konkurrim, nga radhët e anëtarëve të Urdhrit të Psikologut dhe të botës akademike shkencore.
2. Kriteret për të qenë anëtar i Komisionit të Edukimit në Vazhdim
 - Të ketë gradën shkencore Dr., Prof. ose Prof. i asociuar.
 - Të ketë eksperiencë jo më pak se 10 vjet në ushtrimin e profesionit.

- Të mos ketë marrë masë disiplinore.
 - Të mos jetë i dënuar.
3. Anëtarët e Komisionit shpërblehen me honorare bazuar në numrin e mbledhjeve, në vlerën e përcaktuar me vendim nga Këshilli Kombëtar.

Neni 40.4

Mandati i anëtarëve të Komisioni të Edukimit në Vazhdim.

Mandati i anëtarëve të Komisionit të Edukimit në Vazhdim është 3 vjet me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat të dytë. Ndërprerja e mandatit bëhet në rastet e mëposhtme:

- a) Jep dorëheqjen.
- b) Deklarohet i paaftë për të vepruar me një vendim të formës së prerë.
- c) Dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
- d) Merr masë disiplinore nga Komisioni i Etikës dhe Gjykimin Disiplinor i Urdhrit të Psikologut.
- e) Në rast neglizhimi në detyrë, me propozim të Kryetarit të Komitetit Shkencor dhe miratimin e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.
- f) Në rast vdekje.

Neni 40.5

Kompetencat e Komisionit të Edukimit në Vazhdim

Kompetencat e Komisionit të Edukimit në Vazhdim përcaktohen në Rregulloren “Për sistemin e edukimit në vazhdim për profesionin e psikologut”, si dokument bazë mbi të cilin funksionon sistemi i edukimit në vazhdim në Psikologji,

Neni 40.6

Kuorumi dhe vendimarrja e Komisionit të Edukimit në Vazhdim

Komisioni i Edukimit në Vazhdim mbledhet me kërkesë të Kryetarit të tij, sa herë që paraqitet për miratim dhe çertifikim një program trajnimi.

Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Votimi bëhet i hapur.

Anëtarët e Komisionit të Edukimit në Vazhdim gjatë procesit të votimit të hapur nuk mund të abstenojnë. Në rast barazimi të votave, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 40.7

Administrata mbështetëse

Urdhri i Psikologut, në strukturën e vet organizative, merr masat e nevojshme për mbështetjen me burime njerëzore të Komisionit, për realizimin e funksioneve të tij sipas këtij Statuti dhe Rregullores “Për sistemin e edukimit në vazhdim për profesionin e psikologut”

KREU V FINANCAT DHE BUXHETI

Neni 41

Buxheti

1. Urdhri i Psikologut ka buxhetin e vet, të cilin e vetadministron në përputhje me rregullat financiare në fuqi.
2. Burimet financiare të Urdhrit të Psikologut janë:
 - a) kuotizacionet e anëtarëve, të miratuara nga Këshilli Kombëtar;
 - b) tarifat e regjistrimit;
 - c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
3. Të ardhurat, që realizon gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Urdhri i Psikologut i përdor për të përmbushur misionin e caktuar me ligj.
4. Këshilli Kombëtar miraton projekt-buxhetin vjetor, bilancin financiar si dhe pagat e shpërblimet.

Neni 42

Kuotizacionet

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 27.07.2018 të Asamblesë II Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Kuotizacioni vjetor për anëtarët përcaktohet nga Këshilli Kombëtar në fundvit, në varësi të gjendjes, kërkesave dhe nevojave për të siguruar funksionimin normal të Urdhrit të Psikologut. Propozimi për ndryshimin e kuotizacionit vjetor bëhet me shkrim nga cildo prej anëtarëve dhe duhet të përmbajë analizën e efekteve të pritshme financiare. Vendimi i Këshillit Kombëtar në

lidhje me kuotizacionin mund të merret në çdo fundviti, me 2/3 e votave të anëtarëve të tij, dhe hyn në fuqi në vitin pasardhës financiar. Mosarritja e shumës së cilësuar lë në fuqi kuotizacionin aktual.

2. Shlyerja e kuotizacionit është e detyrueshme në fillim të çdo viti kalendarik dhe kushtëzon anëtarësinë në Urdhrit e Psikologut.

Neni 43

Përdorimi i burimeve financiare

1. Burimet financiare të Urdhrit të Psikologut përdoren për:

- a) Paga, honorare, shpërblime pune dhe kontributin për sigurimet shoqërore të punonjësve;
- b) Shpenzime operative;
- c) Shpenzime për organizim të veprimtarive shkencore, profesionale e kualifikuese
- d) Shpenzime për botime me karakter shkencor dhe informativ për nevojat e antarëve;
- e) Blerje mjetesh dhe pajisjesh pune për nevojat e veprimtarisë së Urdhrit të Psikologut;
- f) Shpenzime për pritje e përcjellje delegacionesh e specialistësh nga organizma të ndryshme ndërkombëtare dhe vende të huaja;
- g) Shpenzime për ceremoni të ndryshme në nder të figurave të shquara të psikologjisë;
- h) Ndihma në rast fatkeqësie për anëtarët e Urdhrit dhe familjet e tyre;
- i) Shpenzime të tjera të nevojshme për përmbushjen e misionit të tij.

Neni 44

Shpërblimet financiare

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 27.07.2018 të Asamblesë II Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Pjesëmarrja në mbledhje dhe veprimtari të ndryshme të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, të Komisioneve, si dhe aktivizimi i ekspertëve për konsulencë, hartim projektesh dhe materialesh të rëndësishme, si dhe për shërbime të tjera në funksion të Urdhrit të Psikologut, shpërblehen sipas Rregullores Financiare të Urdhrit të Psikologut, të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 45

Emërtimi

1. Emri i institucionit është “URDHRI I PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Neni 46

Stema dhe vula

1. Urdhri ka stemën dhe vulën e tij.

2. Vula përftohet sipas legjislacionit në fuqi.

3. Logoja miratohet nga Këshilli Kombëtar dhe duhet të përmbajë simbolin e psikologjisë, togfjalëshin “Urdhri i Psikologut” dhe “Republika e Shqipërisë”, si dhe datën e asamblesë themeluese të Urdhrit.

Neni 47

Selia

Selia e Urdhrit të Psikologut është në Tiranë.

Neni 48

Llogaria bankare

Urdhri i Psikologut mban llogari bankare në lekë dhe në valutë të huaj.

Neni 49

Organi periodik

Urdhri i Psikologut, me vendim të Këshillit Kombëtar, mund të nxjerrë organin e tij periodik në formën e një buletini apo reviste për psikologët.

Neni 50
Hyrja në fuqi

Statuti i Urdhrit të Psikologut hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Asambleja Kombëtare.

Miraturar me vendimin nr.1, datë 30.06.2017 të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.